



Planuar / Doretuar Prenjere / Predato Received / Delivery	16.02	2	viti god year
Organi / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	No Prof Dr. No. Prof. No.	Shitja e Protok. Appendix	Sasia Kantimit Quantity
SKM/SHCK	824/2022		116



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.36/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1891/21 të Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.587/2021 të datës 23.06.2021 të parashtruar nga ankuesi i përfaqësuar kundër nga avokat.

Vendimit të datës 26.05.2021 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike "Ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 16.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.587/2021 e datës 23.06.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET në fuqi Vendimi i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë i datës 26.05.2021 me numër protokoli:3920.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit sipas detyrimeve ligjore në pajtim më vendimin A.nr.264/2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil me numër prot:2284/2021 të datës 07.05.2021, Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë ka rishqyrtuar inicimin e procedurës disiplinore sipas kërkesës së datës 01.07.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm duke nxjerr vendimin e datës 26.05.2021 me numër prot:3920 me të cilin ankuesit i shqiptohet masa disiplinore "ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension".



Ankuesi kundër vendimit të Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë të datës 26.05.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës me datë 23.06.2021 e cila është regjistruar me numër protokolli:3273/2021, me pretendimet ankimore se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së vendimit ka shkelur dispozitat ligjore të procedurës administrative, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga data 30.06.2021 deri më datë 05.11.2021 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 05.08.2021, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 13.01.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.1891/21 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 05.08.2021 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankueses të datës 23.06.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 23.06.2021 e parashtruar nga ankuesi me numër protokolli 3273/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Padinë e datës 12.10.2020 të parashtruar nga ankuesi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Vendimin e Këshillit Anr.246/2021 y-të datës 07.05.2021 me numër prot:2284/2021; Vendimi i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë i datës 26.05.2021 me numër protokolli:3920; E-mailin e bashkangjitur të datës 02.12.2019 dërguar nga ankuesi për sekretarin Raporti javor i punës i datës 06.03.2020; E-mailin e datës 17.03.2020 dërguar nga ankuesin dhe me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (2) faqesh; Autorizimin e datës 17.03.2020 me numër ref:Nr.01/; E-mailin e datës 20.03.2020 dërguar nga ankuesin; Pëlqimin e datës 20.03.2020; E-mailin e datës 20.03.2020 dërguar nga ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur pesë (5) faqesh; E-mailin e datës 13.03.2020 dërguar nga ankuesin; E-mailin e datës 28.05.2020 dërguar nga ankuesin; E-mailin e datës 20.03.2020 dërguar nga ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 (dy) faqesh; E-mailin e datës 29.06.2020 dërguar nga ankuesin; E-mailin e datës 07.05.2021 dërguar nga ankuesi në KPMSHCK; E-mailin e datës 06.05.2021 dërguar nga ankuesi për kërkesën e datës 06.05.2021; Njoftimin e datës 31.05.2021 dërguar nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë lidhur me zbatimin e vendimit A.nr.264/2021 të datës 07.05.2021 të KPMSHCK-së; Ankesën e datës 14.08.2020 e parashtruar nga ankuesi me numër protokolli 1555/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 05.12.2019 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm Kopjen e kontratës së datës 24.12.2019 (vetëm faqen e nënshkruar) me "Hib Petrol" ShPK; Raportin javor të punës për datat respektive 02-06.03.2020; E-mailin e datës 17.03.2020 dërguar nga ankuesin me korrespondencën; e bashkangjitur prej 2 (dy) faqesh; Autorizimin e datës 17.03.2020 me numër Ref.nr.01; E-mailin e datës 20.03.2020 dërguar nga ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 (dy) faqesh; Pëlqimin e datës 20.03.2020; E-mailin e datës 13.03.2020 dërguar nga ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 5 (pesë) faqesh; E-mailin e datës 28.03.2020 dërguar nga ankuesin; E-mailin e datës 29.06.2020 dërguar nga ankuesin me korrespondencën; E-mailin e datës

23.06.2020 dërguar nga PATRONI KS për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 (dy) faqesh; E-mailin e datës 24.06.2020 dërguar nga _____ për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 (dy) faqesh; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor të datës 13.07.2020; vendimin me numër protokolli: 4085 të Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë i datës 20.07.2020; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 20.08.2020; Përgjigjen në kërkesë të datës 27.08.2020; Akt emërimin e ndryshuar dhe plotësuar të datës 22.01.2019; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Departamentit për Rezervave Shtetërore të Mallrave; Kontratën e datës 29.06.2020 me numër protokolli:3214 në përmbajtje prej 14 faqesh; Kontratën e datës 04.06.2020 me numër protokolli:2603 në përmbajtje prej 3 faqesh; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor të datës 07.07.2020; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor të datës 16.07.2020; E-mailin e datës 07.07.2020 dërguar nga _____ për _____ me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 (dy) faqesh; E-mailin e datës 01.07.2020 dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm _____ për _____ me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 (dy) faqesh; E-mailin e datës 07.07.2020 dërguar nga _____ për _____ me korrespondencën e bashkangjitur prej 1 (një) faqe; E-mailin e datës 16.07.2020 dërguar nga _____ për _____ me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 (dy) faqesh; Vërejtjen me shkrim të datës 27.11.2018 me numër Ref.02.Nr; Kërkesën e datës 04.08.2020 me numër reference:04/2020; Regjistrin e vijueshmërisë në punë për ankuesin prej datës 01.01.2019 deri me datë 02.07.2020; Vendimin e datës 13.07.2020 me numër Ref.02/Nr.163 të Sekretarit të Përgjithshëm; Aktgjykimin A.nr.1684/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 01.04.2021; Ftesat për seancë publike të datës 29.04.2021 me numër protokolli 2070/2021 dërguar për ankuesin dhe përfaqësuesit e ministrisë; Procesverbalin e seancës publike të mbajtur me datë 05.05.2021 në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 31.05.2021 me numër prot:2730/2021; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 26.05.2021; Njoftimin e datës 05.08.2021, Aktgjykimin A.nr.1897/21 të Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 13.01.2022; Parashtrësën e përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit të datës 27.01.2022.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____ është *e pabazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër protokolli: 3920 të datës 26.05.2021 ka shkelur dispozitat ligjore të procedurës administrative, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër protokolli: 3920 të datës 26.05.2021 ankuesit i ka shqiptuar masa disiplinore *"ndërprerje e marrëdhënies së punës në shërbimin civil pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension"* për shkak të konstatimit se i njëjti ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës me rastin e nënshkrimit të dy (2) kontratave, respektivisht nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik "Patroni SHPK" të datës 29.06.2020 dhe asaj me "Ada Group SHPK & Kajmak SHPK" të datës 04.06.2020, pa autorizimin dhe pëlqimin paraprak nga titullari i institucionit-ministri i Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 87 paragrafi 1 i cili përcakton se: *"Nëpunësi civil shkarkohet nga shërbimi civil për shkak të performancës dhe rezultateve të dobëta, shkeljes së kodit të mirësjelljes dhe shkeljes së ligjit, i cili ka rezultuar me vepër penale, siç është përcaktuar me këtë ligj."*, si dhe neni 66 paragrafi 1 dhe 2, i të njëjtit ligj cilët përcaktojnë se: *"1.Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat*

dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil. Rastet e shkeljeve jashtëzakonisht të rënda përcaktohen me akt nënligjor” si dhe ”2. Shkeljet e detyrave të punës ndahen në: shkelje të lehta dhe shkelje të rënda – serioze të cilat do të rregullohen me akt nënligjor “ si dhe dispozitat e Rregullores nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, neni 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 i cili përcaktojnë se: ... “Shkelje të rënda-serioze konsiderohen: shkelja e detyrave të punës që kanë pasoja për palën dhe organin shtetëror”, si dhe neni 8 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1; 1.2, 1.3; 1.4 dhe 1.5 i të njëjtës rregulloreje të cilët përcaktojnë se: “ Për shkelje të rënda-serioze të përcaktuara me nenin 6 të kësaj rregulloreje, nëpunësit civil, mund t’i shqiptohen këto masa disiplinore: 1.1 pezullimi parandalues me pagesë deri në (3) muaj në pritje të një hetimi, i cili duhet të propozohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe miratohet nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit në institucion; 1.2 pezullimi i ushtrimit të detyrave dhe ndalimi i 1/3 së rrogës për një periudhë deri në dy (2) muaj nga komisioni disiplinor pas kërkesës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë; 1.3 largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet nga komisioni disiplinor; 1.4 ndërprerja e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil nga komisioni disiplinor, pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension; dhe 1.5 pensionim i parakohshëm i nëpunësve civil, të cilëve u kanë mbetur edhe dy (2) vjet deri në datën e pensionimit”, andaj mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se masa disiplinore “ndërprerje e marrëdhënies së punës” e cila i është shqiptuar ankuesit është masa më e rëndë disiplinore që shqiptohet në shërbimin civil, ndërsa ankuesi ka pasur edhe me herët të shqiptuar masa disiplinore nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm siç është vërtetuar në bazë të shkresë së lëndës të datës 27.11.2018.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë si dhe gjatë deklarimeve të palëve në procedurë në seancën publike të mbajtur nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 05.05.2021, Kolegji ka konstatuar se kontratat e lartë cekura ankuesi i ka nënshkruar pa pëlqimin dhe autorizimin paraprak të titullarit të institucionit siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-244 për Rezervat Shtetërore neni 18 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 dhe 1.17 i cili përcakton se: “Në kuadër të funksioneve dhe detyrave të Departamentit, drejtori i Departamentit ushtron kompetencat si më poshtë: 1.1. përfaqëson Departamentin me autorizim të Ministrisë dhe 1.7. në pëlqim paraprak me Ministrinë përcakton vendosjen e Rezervave Shtetërore të mallrave”, pasi që ankuesi në provat e bashkangjitura edhe në ankesën e parashtruar me datë 14.08.2020 sikurse edhe në ankesën e datës 23.06.2021 ka ofruar si prova një autorizim të datës 10.03.2020 dhe pëlqimin e datës 20.03.2020 i cili është draftuar në aspektin juridik dhe teknik nga Udhëheqësi i Divizionit për hartimin dhe Harmonizimin e legjislacionit, respektivisht nga Drejtor Departamentit Ligjor, mirëpo as autorizimi dhe as pëlqimi në fjalë nuk janë të nënshkruar nga titullari i institucionit-ministri siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-244 për Rezervat Shtetërore dhe me këtë rast Kolegji vlerëson se dokumentet e tilla nuk e kanë fuqinë juridike dhe si të tilla nuk prodhojnë efekte dhe mbi këtë bazë nënshkrimi i dy (2) kontratave respektive përkatësisht nënshkrimi të kontratës në mënyrë të pavarur nga ana e ankuesit me operatorin ekonomik “Patroni SHPK” të datës 29.06.2020 dhe asaj me “Ada Group SHPK & Kajmak SHPK” të datës 04.06.2020, pa pëlqimin dhe autorizimin paraprak të vërtetuar dhe nënshkruar nga ana e titullarit të institucionit-ministrit, ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës siç janë të përcaktuara në Rregulloren (QRK) - NR. 04/2015 Për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të republikës së Kosovës neni 10 paragrafi 1 i cili përcakton se: “Nëpunësit civil duhet të zbatojnë politikën e veprimit të udhëheqësve drejtues dhe sjellja e tyre duhet të jetë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi” si dhe me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 të Rregullores nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil i cili përcakton se: “Shkelje të rënda-serioze konsiderohen: shkelja e detyrave të punës që kanë pasoja për palën dhe organin shtetëror” dhe po ashtu ankuesi në përshkrimin e tij të detyrave kryesore të punës ndër të tjerash e ka edhe pikën: “në pëlqim paraprak me Ministrinë përcakton vendosjen e

rezervave shtetërore të mallrave”, ndërsa ankuesi nuk ka arritur të dëshmojë me shkrim apo në ndonjë formë tjetër se Ministri përkatës ka dhënë pëlqim për nënshkrimin e kontratave të referuara si më lartë.

Lidhur me pretendimet e palës ankuese të parashtruara me datë 27.01.2022 me rastin e kërkesë për plotësimin e ankesës së datës 23.06.2021 nga përfaqësuesi i autorizuar i palës sipas autorizimit të datës 27.01.2022, se vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 20.07.2020 si dhe Vendimi me numër ref:3920 i datës 26.05.2021 janë nxjerrë në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë të paraparë në nenin 4 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit.Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe janë nxjerrë mbi bazën e një ligji që nuk është në fuqi dhe si të tilla janë vendime të kundërligjshme ashtu siç parashihet me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.3 dhe 1.5 të Ligjit.Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji konstaton se Këshilli me Vendimin A.nr.264/2021 të datës 07.05.2021 në pikën I të diapozitivit të tij e ka shfuqizuar Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 20.07.2020 dhe si i tillë nuk mund të jetë objekt shqyrtimi i kësaj ankese siç parashihet edhe me nenin 101 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit.Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të palës ankuese se Vendimi me numër ref:3920 i datës 26.05.2021 është nxjerrë në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë të paraparë në nenin 4 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit.Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe është nxjerrë mbi bazën e një ligji që nuk është në fuqi dhe si i tillë është vendim i kundërligjshëm ashtu siç parashihet me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.3 dhe 1.5 të Ligjit.Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që është nxjerr në kundërshtim me ligjin material, Kolegji ka konstatuar se veprimet e ankuesit mbi bazën e të cilave Komisioni Disiplinor ka evidentuar se i njëjti ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës me rastin e lidhjes respektivisht nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik “Patroni SHPK” të datës 29.06.2020 dhe asaj me “Ada Group SHPK & Kajmak SHPK” të datës 04.06.2020, pa autorizimin dhe pëlqimin paraprak nga titullari i institucionit-ministri i Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë, janë veprime të cilat janë ndërmarrë në kohën sa kanë qenë të aplikuara dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe të gjitha aktet e tjera nën ligjore që rrjedhin prej tij, ndërsa sipas Aktgjykimit Nr. ref.:AGJ 1583/20 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës të datës më 9 korrik 2020, Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka hyrë në fuqi po në të njëjtën datë, mirëpo në asnjë dispozitë të tij nuk ka përcaktuar se ligji ka fuqi retroaktive, ndërsa sa i përket dispozitave kalimtare të nenit 83 paragrafi 9 i Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka përcaktuar se: *“...Për procedurat disiplinore në proces, nëse kjo është më e favorshme për nëpunësin civil në fjalë, me kërkesën e tij, zbatohen procedurat e ligjit të ri. E njëjta procedurë do të aplikohet për procedurat e ankesave dhe kontesteve”*, ndërlidhur me procedurën në kohën e shkeljes së pretenduar, inicimi i procedurës disiplinore i datës 01.07.2020 nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm është bërë në pajtim me nenin 12 të Rregullores Nr.04/2012 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, ngase në rastin konkret Sekretari i Përgjithshëm ka qenë edhe Udhëheqës i tij i drejtpërdrejt dhe se në kërkesën e datës 01.07.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm dërguar përmes e-maili ka qenë e përfshirë edhe Menaxherja e Njesisë së Burimeve Njerëzore siç përcaktohet me nenin 12 paragrafi 2 të së njëjtës rregullore, andaj mbi këtë bazë pretendimet e përfaqësuesit të palës ankuese se inicimi i procedurës disiplinore në rastin konkret është i kundërligjshëm pasi që nuk janë përfillë procedurat e përcaktuara në nenin 11 dhe 12 të Rregullores Nr.04/2012 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil janë të paqëndrueshme, ngase neni 11 i së njëjtës rregullore ka të bëjë me rastet kur inicimi i procedurës disiplinore bëhet sipas dispozitave të përcaktuara në nenin 10 të Nr.04/2012 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së vendimit të datës 26.05.2021 me numër prot:3920 përmes të cilit ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore “Ndërprerje e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil”, ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit.Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe me dispozitat e aplikuar të ligjit material respektivisht Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës në kohën kur ankuesi ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës, ndërsa në vendimi në fjalë në arsyetimin e tij është përcaktuar edhe cilat nga nenet e ligjit në fjalë dhe akteve tjera nënligjore i ka shkelur ankuesi me rastin e lidhjes respektivisht nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik “Patroni SHPK” të datës 29.06.2020 dhe asaj me “Ada Group SHPK & Kajmak SHPK” të datës 04.06.2020 pa autorizimin dhe pëlqimin paraprak nga titullari i institucionit-ministri i Ministrisë së Tregtisë, duke iu referuar kështu edhe shkeljeve të dispozitave të Ligjit Nr.03/L-244 për Rezervat Shtetërore të Mallrave.

Kolegji, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës dhe pasi ka peshuar të gjitha provat veç e veç një nga një dhe së bashku në tërësi, ka konstatuar se ankuesi me rastin e nënshkrimit të dy kontratave siç është lartëshënuar në arsyetim të këtij vendimi, ka ardhur në përfundim unanimitet se masa e aplikuar ndaj ankuesit është masë disiplinore në proporcion me shkeljen e bërë nga ana e ankuesit si dhe është në harmoni me të gjitha aktet ligjore në fuqi që kane rregulluar marrëdhënien e punës në shërbimin civil të Kosovës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.36/2022

Flakron GASHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit, Avokatit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Z. Kreshnik Kaçiu, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative
- Arkivit të KPMSHCK-së

